



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2023:156896
Datë: 18.06.2024
Numri i dokumentit: 05828961

C.nr.670/2023

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Betim Behluli, me bashkëpunëtorin profesional Armond Qmega, në çështjen juridike të paditëses V.Z, nga fshati Pataqan i Poshtëm, Komuna e Rahovecit, të cilin e përfaqëson Av. D.M, nga Prizreni, kundër të paditurës S në Prishtinë, lidhur me kompenzimin e dëmit, vlera e kontestit 1,500.00 €, me datë 18.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Padia e paditëses V.Z, nga fshati Pataqan i Poshtëm, Komuna e Rahovecit, e ushtruar pranë kësaj gjykate, kundër të paditurës S në Prishtinë, lidhur me kompenzimin e dëmit, **KONSTATOHET E TËRHEQUR.**

Lënda si e kryer ti deponohet arkivit të gjykatës.

A r s y e t i m

Paditësja V.Z, nga fshati Pataqan i Poshtëm, Komuna e Rahovecit, ka ushtruar padinë kundër të paditurës S në Prishtinë, lidhur me kompenzimin e dëmit.

Përfaqësuesi i autorizuar i paditëses me parashtresë të veçantë e ka tërhequr padinë.

Andaj kjo gjykatë e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 261 paragrafi 1 dhe 4 të Ligjit për Procedurën Kontestimore të Kosovës, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke konsideruar se padia e paditëses është tërhequr.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC
C.nr.670/2023, më 18.06.2024

B. Profesional
Armond Qmega

Gjyqtari
Betim Behluli

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa e veçantë.